PHILIPS

AVENT

SCF358

Manuali i përdorimit

Përmbajtja

E rëndësishme **3**

Hyrje **5**

Përshkrim i përgjithshëm **6**

Përmbledhje e produktit 6

Shpjegimi i cilësimeve 7

Ngrohja e qumështit 8

Ushqejani foshnjës qumështin 10

Ngrohësen e shishes mund ta ripërdorni menjëherë për të shishe të tjera 11

Ngrohja e qeskës së qumështit 11

Ngrohja e ushqimit për foshnja 13

Ushqejeni foshnjën me ushqimin për foshnja 14

Ngrohësen e shishes mund ta ripërdorni menjëherë për enë të tjera ushqimesh për foshnja 15

Mbajtja ngrohtë e qumështit 15

Shkrirja e qumështit 16

Shkrirja e ushqimit për foshnja 18

Pastrimi dhe deskorjezimi **20**

Pastrimi 20

Deskorjezimi 21

Riciklimi **21**

Mbështetja **21**

Zgjidhja e problemeve **22**

E rëndësishme

Lexojeni me kujdes këtë manual përdorimi përpara se ta vini në punë pajisjen, si dhe ruajeni për referencë në të ardhmen.

Rrezik

- Mos e zhysni kordonin, spinën apo pajisjen në ujë apo në lëngje të tjera.

Paralajmërim

- Përdoreni pajisjen vetëm në ambiente të mbyllura.
- Mos e lini kordonin elektrik të varet nga skaji i tryezës apo syprina. Kordonin e tepërt ruajeni në bazamentin e ngrohësit të shishes.
- Mbajeni kordonin elektrik larg sipërfaqeve të nxehta.
- Pajisjen lidheni vetëm me priza të tokëzuara. Sigurohuni gjithnjë që spina të futet siç duhet në prizë.
- Përpara se ta lidhni pajisjen, kontrolloni nëse voltazhi i përcaktuar në fund të pajisjes përkon me voltazhin lokal.
- Nëse ju duhet të përdorni një kordon zgjatues, sigurohuni të jetë kordon i tokëzuar zgjatues me specifikim prej së paku 13 amperësh.
- Mos e përdorni pajisjen nëse spina, kordoni elektrik apo pajisja vetë është e dëmtuar. Nëse kordoni elektrik është i dëmtuar, duhet ta ndërroni nga Philips, një pikë servisi e autorizuar nga Philips ose nga persona me kualifikim të ngjashëm, në mënyrë që të shmangni rreziqet.
- Mos e vendosni pajisjen mbi apo pranë furnelave të nxehta me gaz apo elektrike, apo në furrë të ndezur.
- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë me aftësi të reduktuara fizike, shqisore apo mendore, apo që kanë mungesë përvoje dhe njohurish vetëm nëse u kushtohet mbikëqyrja e duhur apo u jepen udhëzime në lidhje me përdorimin e sigurt të pajisjes, si dhe të kuptojnë rreziqet e përfshira.

- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë të moshës 8 vjeç e lart nëse ata mbikëqyren ose udhëzohen për përdorimin e sigurt të pajisjeve dhe nëse ata kuptojnë rreziqet e përfshira. Pastrimi dhe mirëmbajtja nga përdoruesi nuk duhen kryer nga fëmijët, përveç nëse janë më të mëdhenj se 8 vjeç dhe nën mbikëqyrje. Mbajeni pajisjen dhe kordonin larg vendeve ku mund të arrihet nga fëmijët nën 8 vjeç.
- Fëmijët nuk duhet të luajnë me pajisjen.
- Mos derdhni ujë mbi spinën elektrike.
- Përdoreni pajisjen vetëm sipas përshkrimit në manualin e përdorimit për të evituar lëndimet për shkak të keqpërdorimit.
- Mos e parangrohni pajisjen.
- Vendoseni gjithnjë shishen të mbyllur me kapak në ngrohësen e vet përpara se t'i shtoni ujë.
- Sigurohuni të shtoni ujë përpara se ta ndizni ngrohësen e shishes.
- Uji i nxehtë mund të shkaktojë djegie të rënda. Bëni kujdes kur ngrohësja e shishes përmban ujë të nxehtë.
- Sipërfaqet e arritshme të pajisjes mund të nxehen gjatë përdorimit dhe mund të mbesin të tilla pas përdorimit.
- Mos e hiqni pajisjen kur përmban ujë të nxehtë.
- Kur ushqimi apo qumështi ka arritur temperaturën e kërkuar, hiqeni shishen ose enën nga ngrohësja e shishes. Nëse e lini ushqimin apo qumështin në ngrohësen e shishes, temperatura e ushqimit apo e qumështit do të rritet.

Kujdes

- Kjo pajisje synohet për përdorim në shtëpi dhe për përdorime të ngjashme si p.sh. shtëpi ferme, hostele, zona kuzhine të personelit në dyqane, zyra apo ambiente të tjera pune, si dhe nga vizitorët në hotele, motele dhe ambiente të tjera banimi.
- Ushqimi nuk duhet ngrohur për shumë kohë.

- Kontrollojeni gjithnjë temperaturën e ushqimit përpara se të ushqeni fëmijën. Përziejeni me të lehtë shishen dhe kontrollojeni duke hedhur ca pika nga ana e brendshme e kyçit të dorës. (Ndiqni udhëzimet në seksionin "Ushqyerja e foshnjës me qumësht".)
- Hiqeni pajisjen nga priza kur nuk e përdorni.
- Sipërfaqja e rezistencës mund të ketë nxehtësi të mbetur edhe pas përdorimit.
- Lëreni pajisjen të ftohet përpara se ta pastroni.
- Ndiqni udhëzimet e deskoriezimit për të evituar dëme të paripareshme.
- Mos u përpiqni ta hapni apo riparoni vetë pajisjen. Kontaktoni me qendrën e shërbimit të klientit të "Philips" për shtetin tuaj (shihni **www.philips.com/support**).

Data e kodit të prodhimit YYWW ndodhet në folenë e mbajtjes së kordonit në bazamentin e ngrohëses së shishes.

Fushat elektromagnetike (EMF)

Pajisja Philips është në përputhje me të gjitha standardet dhe rregulloret në fuqi për ekspozimin ndaj fushave elektromagnetike.

Hyrje

Urime për blerjen dhe mirë se vini pranë Philips Avent! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që ofron "Philips Avent", regjistrojeni produktin në faqen **www.philips.com/welcome**.

Me këtë ngrohës shisheje mund ta ngrohni dhe shkrini qumështin në mënyrë të sigurt në "Philips Avent" dhe në shishet e tjera më të zakonshme të markave, si dhe ushqimin e foshnjave në enë.

Kjo ngrohëse shisheje është projektuar për ngrohjen e lehtë të qumështit. Ndaj uji në ngrohësen e shishes nuk arrin kurrë temperatura vlimi. Çdo cilësim ngrohjeje është programuar për ngrohjen e vëllimeve të ndryshme të qumështit. Për rendiment më të mirë, sigurohuni që:

1. Ta vendosni shishen në ngrohësen e shishes.
2. Ta mbushni me ujë të pijshëm në temperaturë ambienti deri në nivelin e qumështit
3. Të zgjidhni vëllimin e qumështit dhe të shtypni butonin e ndezjes/fikjes.

Përshkrim i përgjithshëm

Përmbledhje e produktit



A	Ngrohës shisheje	**D**	Cilësimi i mbajtjes së ngrohtë/ shkrirjes
B	Treguesi i ecurisë	**E**	Cilësimi i vëllimit të qumështit
C	Cilësimi i ngrohjes së ushqimit për foshnja	**F**	Butoni i ndezjes/fikjes

Shpjegimi i cilësimeve



Vëllimi i qumështit

- Zgjidhni këtë cilësim për ta ngrohur qumështin që është në temperaturën e dhomës ose në temperaturën e frigoriferit.
- Zgjidhni vëllimin e qumështit për ngrohje. Mund të caktoni nga 30 ml / 1 oz deri në 330 ml / 11 oz. Ngrohësja e shishes e ngroh qumështin në temperaturën e dëshiruar. Qumështi është gati për ushqyerje pasi të jetë ndezur në tërësi treguesi i ecurisë. Nëse e doni më të ngrohtë qumështin, mbajeni shishen në pajisje derisa të arrijë temperaturën e dëshiruar. Nxirreni shishen dhe kontrollojeni temperaturën e qumështit përpara se ta ushqeni foshnjën. Shishen mund dhe ta mbani të ngrohtë në pajisje, dhe do të fiket automatikisht pas rreth 60 minutash.
- Kontrolloni temperaturën e qumështit duke lëshuar disa pika nga brenda kyçit të dorës. Ky qumësht mund të duket i freskët për ju, por ai është i këndshëm për një foshnjë të sapolindur. Kërkimet kanë treguar se shumica e foshnjave e pranojnë qumështin që është më i freskët se temperatura e trupit.

Ngrohja e ushqimit për foshnja

- Zgjidhni këtë cilësim për ngrohjen e ushqimit për foshnja.
- Për rezultate optimale, trazojeni ushqimin e foshnjës gjatë ngrohjes.

Mbajtja ngrohtë / shkrirja

- Sensori i integruar e rregullon modelin e ngrohjes për mbajtje ngrohtë ose shkrirje.
- Nëse qumështi/ushqimi i foshnjës është i ngrohtë, do të ngrohet gradualisht dhe do të mbahet në temperaturën e duhur.
- Nëse qumështi është i ngrirë, do të shkrihet fillimisht në gjendje të lëngët dhe në vijim do të ngrohet në temperaturën e duhur. Mund ta shkrini qumështin nga 30 ml/ 1 oz deri në 180 ml/ 6 oz.
- Nëse ushqimi i foshnjës është i ngrirë, do të shkrihet. Pas kësaj, fikeni ngrohësen e shishes dhe kalojeni te cilësimi i ushqimit të foshnjës për ta ngrohur ushqimin e foshnjës.
- Zgjidhni këtë cilësim për të ngrohur qeskën e qumështit. Materiali i qeskës së qumështit e transferon shumë shpejt nxehtësinë.

Kur treguesi i të gjithë ecurisë është i ndezur, por jo duke pulsuar, qumështi është gati për t'iu ushqyer foshnjës. Ushqejeni foshnjën pasi qumështi të jetë ngrohur. Mos e ngrohni përsëri qumështin pas ftohjes, pasi mund të fillojnë të zhvillohen baktere brenda tij.
Sa i përket ushqimit për foshnja, për shkak të ndryshimeve në përbërjen e ushqimit të foshnjave, pajisja nuk ka mundësi ta kuptojë saktë se për sa kohë duhet ngrohur ushqimi për foshnja. Kur treguesi i të gjithë ecurisë është i ndezur, por jo duke pulsuar, mbajeni ushqimin në pajisje për ta ngrohur më tej. Trazojeni ushqimin për foshnja ndërsa kavanozi apo ena është në ngrohëse. Për rezultate sa më të mira, kontrolloni temperaturën gjatë ngrohjes.

Ngrohja e qumështit

1 **Vendosni shishen në ngrohësen e shishes. Mbusheni me ujë të pijshëm deri në nivelin e qumështit. Nëse keni sasi të madhe qumështi, p.sh. 210 ml/7 oz, mbusheni me ujë afro 1 cm poshtë majës së ngrohëses së shishes.**



2 **Zgjidhni cilësimin e dëshiruar sipas sasisë së qumështit dhe shtypni butonin e ndezje/fikjes për ta ndezur.**





3 **Treguesi i ecurisë pulson gradualisht për të shfaqur ecurinë e ngrohjes që qumështit.**



4 **Kur treguesi i gjithë ecurisë të qëndrojë ndezur, qumështi është gati për t'u dhënë për ushqim dhe ngrohësja e shishes ndizet vetë për të ruajtur modalitetin e ngrohjes.**

5 **Ngrohësja e shishes fiket vetë pas rreth 60 minutash, duke përfshirë kohën e ngrohjes. Fiket treguesi i ecurisë.**



Këshillë

- Nëse e doni më të ngrohtë qumështin, mbajeni shishen në pajisje derisa të arrijë temperaturën e dëshiruar pas ndezjes së treguesit të të gjithë ecurisë.
- Nëse përdorni shishe silikoni, do duhet më shumë kohë për ngrohjen e qumështit. Mbajeni në ngrohësen e shishes për 3-4 minuta pasi të ndizet treguesi i të gjithë ecurisë.
- Shishet e qelqit ngrohen shpejt. Përdorni një cilësim më të ulët. Për më shumë informacion, kontrolloni tabelën në seksionin e cilësimeve **Të rekomanduara sipas llojit të enës së qumështit**.

Cilësimet e rekomanduara sipas llojit të enës së qumështit

Kontrolloni tabelën e mëposhtme për cilësimet e rekomanduara të ngrohjes së qumështit bazuar në llojin e enës suaj.

Ena e qumështit	Temperatura fillestare e qumështit	Vëllimi i qumështit	Cilësimi i rekomanduar
Qelq	22°C/72°F	1-3 ons/30-90 ml	1 ons/30 ml
		4-6 ons/120-180 ml	2 ons/60 ml
		7-8 ons/210-240 ml	4 ons/120 ml
	5°C/40°F	1 ons/30 ml	1 ons/30 ml
		2-6 ons/60-180 ml	2 ons/60 ml
		7-8 ons/210-240 ml	4 ons/120 ml
Plastikë	22°C/72°F ose 5°C/40°F	1-11 ons/30-330 ml	Cilësimi i vëllimit të qumështit
Silikon	22°C/72°F ose 5°C/40°F	1-9 ons/30-270 ml	Cilësimi i vëllimit të qumështit + 3-4 min
Qese e ruajtjes së qumështit	22°C/72°F ose 5°C/40°F	1-6 ons/30-180 ml	Cilësimi i mbajtjes ngrohtë/ shkrirjes

Kontrolloni udhëzimet e qeses së qumështit dhe sigurohuni që mund të ngrohet në një ngrohës për shishe.

Shënim

- Koha për ngrohjen e qumështit varet nga vëllimi, temperatura fillestare dhe lloji i shishes së qumështit.
- Nëse doni ta ndryshoni cilësimin pas ndezjes së ngrohëses së shishesh, duhet fillimisht ta fikni ngrohësen e shishes. Ndryshojeni cilësimin dhe rindizeni. Ndryshimi i cilësimi kur ngrohësja e qumështit është ndezur për 20 sekonda e lart, e kalon pajisjen automatikisht në modalitetin e mbajtjes ngrohtë.

Ushqejani foshnjës qumështin

Shtypni butonin e ndezje/fikjes për ta fikur pajisjen dhe për ta nxjerrë jashtë shishen e qumështit.



Shënim

- Nëse përdorni shishen e vogël të qumështit, si p.sh. shishe qumështi 60 ml/2 oz, bëni kujdes nga uji i nxehtë kur ta nxirrni shishen jashtë.

Kontrollojeni gjithnjë temperaturën e qumështit përpara se ta ushqeni foshnjën. Përziejeni me të lehtë shishen dhe kontrollojeni duke hedhur ca pika nga ana e brendshme e kyçit të dorës.



Pas çdo përdorimi, hiqeni ngrohësen e shishes nga priza dhe lëreni të ftohet. Hiqeni ujin nga ngrohësja e shishes për arsye higjienike.



Ngrohësen e shishes mund ta ripërdorni menjëherë për të shishe të tjera

Nëse dëshironi të ngrohni një shishe tjetër, lëreni ngrohësen e shishes të ftohet. Për ta përshpejtuar, rimbusheni ngrohësen me ujë të ri të ftohtë.
Kur ta ndizni ngrohësen, treguesi i ecurisë pulson gradualisht për të treguar se pajisja po ringrohet.

Shënim

- Nëse treguesi i ecurisë është i ndezur por nuk pulson, ngrohësja është ende shumë e nxehtë për të ngrohur një shishe tjetër. Fikeni ngrohësen e shishes dhe lëreni të ftohet.

Ngrohja e qeskës së qumështit

Kontrolloni udhëzimet në paketimin e qumështit dhe sigurohuni që mund të ngrohet në ngrohëse shisheje.

1 Vendosni qeskën e qumështit në ngrohësen e shishes. Mbusheni me ujë të pijshëm deri në nivelin e qumështit. Nëse keni sasi të madhe qumështi, mbusheni me ujë afro 1 cm poshtë majës së ngrohëses së shishes.





2 **Zgjidhni cilësimin e mbajtjes ngrohtë/shkrirjes dhe shtypni butonin e ndezjes/fikjes për ta ndezur. Materiali i qeskës së qumështit e transferon shumë shpejt nxehtësinë, ndaj është më mirë ta përdorni këtë cilësim.**





3 **Treguesi i ecurisë pulson për të treguar se është në proces ngrohjeje.**



4 **Kur treguesi i gjithë ecurisë të qëndrojë ndezur, qumështi është gati për t'u dhënë për ushqim dhe ngrohësja e shishes ndizet vetë për të ruajtur modalitetin e ngrohjes.**

5 **Ngrohësja e shishes fiket vetë pas rreth 60 minutash, duke përfshirë kohën e ngrohjes. Fiket treguesi i ecurisë.**



Ngrohja e ushqimit për foshnja

1 **Vendosni enën e ushqimit të foshnjës në ngrohësen e shishes. Mbusheni me ujë të pijshëm deri në nivelin e ushqimit të foshnjës. Nëse keni sasi të madhe ushqimi për foshnja, p.sh. 210 ml/7 oz, mbusheni me ujë afro 1 cm poshtë majës së ngrohëses së shishes.**





2 **Zgjidhni cilësimin e ngrohjes së ushqimit për foshnja dhe shtypni butonin e ndezje/fikjes për ta ndezur.**



3 **Treguesi i ecurisë pulson për të treguar se është në proces ngrohjeje.**

4 **Për shkak të ndryshimeve në njëtrajtësinë e ushqimit, pajisja nuk ka mundësi ta kuptojë saktë se për sa kohë duhet ftohur ushqimi për foshnja. Trazojeni ushqimin për foshnja ndërsa kavanozi apo ena është në ngrohëse. Për rezultate optimale, kontrollojini temperaturën gjatë ngrohjes.**

↳ **Bëni kujdes të mos digjni gishtat kur e mbani enën apo kavanozin gjatë trazimit.**



Shënim

- Kur treguesi i të gjithë ecurisë qëndron vazhdimisht i ndezur, mbajeni ushqimin e foshnjës në pajisje për ta ngrohur edhe më tej. Trazojeni ushqimin e foshnjës dhe kontrollojini temperaturën.

5 **Ngrohësja e shishes fiket vetë pas rreth 60 minutash, duke përfshirë kohën e ngrohjes. Fiket treguesi i ecurisë.**



Ushqejeni foshnjën me ushqimin për foshnja

Shtypni butonin e ndezje/fikjes për ta fikur pajisjen dhe për ta nxjerrë jashtë enën apo kavanozin e ushqimit..



Kontrollojeni gjithnjë temperaturën e ushqimit për foshnja përpara se ta ushqeni foshnjën. Trazojeni lehtë ushqimin e foshnjës në enën apo kavanozin e ushqimit dhe provojeni vetë përpara për t'u siguruar që nuk është shumë i nxehtë.

Ngrohësen e shishes mund ta ripërdorni menjëherë për enë të tjera ushqimesh për foshnja

Ndiqni të njëjtit hapa siç tregohet në seksionin "Ngrohja e qumështit"

Mbajtja ngrohtë e qumështit

Me këtë cilësim, sensori i integruar e rregullon modelin e ngrohjes për mbajtje ngrohtë ose shkrirje. Nëse vendosni qumësht të ngrohtë, ai ngrohet gradualisht dhe mbahet në temperaturën e duhur.

1 **Vendosni shishen në ngrohësen e shishes. Mbusheni me ujë të pijshëm deri në nivelin e qumështit. Nëse keni sasi të madhe qumështi, mbusheni me ujë afro 1 cm poshtë majës së ngrohëses së shishes.**





2 **Zgjidhni cilësimin e mbajtjes ngrohtë/shkrirjes dhe shtypni butonin e ndezje/fikjes për ta ndezur.**





3 **Treguesi i cilësisë pulson për të treguar se qumështi po ngrohet.**



4 **Kur treguesi i gjithë ecurisë të qëndrojë ndezur, qumështi është gati për t'u dhënë për ushqim dhe ngrohësja e shishes e mban qumështin në këtë temperaturë.**

5 **Ngrohësja e shishes fiket vetë pas rreth 60 minutash, duke përfshirë kohën e ngrohjes. Fiket treguesi i ecurisë.**



Shënim

- Koha mund të ndryshojë në varësi të sasisë së qumështit dhe temperaturës së nisjes.

Shkrirja e qumështit

Me këtë cilësim, sensori i integruar e rregullon modelin e ngrohjes për mbajtje ngrohtë ose shkrirje. Nëse vendosni qumësht të ngrirë, ngrohësja do ta shkrijë fillimisht qumështin në gjendje të lëngët dhe në vijim do ta ngrohë në temperaturën e duhur. Mund ta shkrini qumështin nga 30 ml/ 1 oz deri në 180 ml/ 6 oz.

1 **Vendosni shishen në ngrohësen e shishes. Mbusheni me ujë të pijshëm deri në nivelin e qumështit. Nëse keni sasi të madhe qumështi, mbusheni me ujë afro 1 cm poshtë majës së ngrohëses së shishes.**





2 **Zgjidhni cilësimin e mbajtjes ngrohtë/shkrirjes dhe shtypni butonin e ndezje/fikjes për ta ndezur.**





3 **Treguesi i cilësisë pulson për të treguar se qumështi po shkrin dhe po ngrohet.**



4 **Për shkak të ndryshimeve në njëtrajtësinë e qumështit të ngrirë, pajisja nuk ka mundësi ta kuptojë saktë se për sa kohë duhet ngrohur. Kur treguesi i të gjithë procesit të qëndrojë vazhdimisht i ndezur, mbajeni qumështin në pajisje për ngrohje të mëtejshme.**

Shënim

- P.sh. për të shkrirë e ngrohur një shishe prej 60 ml/2 oz qumësht të ngrirë, do të marrë 45 minuta. Koha e shkrirjes dhe e ngrohjes mund të jetë më e gjatë ose më e shkurtër në varësi të vëllimeve të qumështit dhe materialit të enës.

5 **Ngrohësja e shishes fiket vetë pas rreth 60 minutash, duke përfshirë kohën e shkrirjes dhe të ngrohjes. Fiket treguesi i ecurisë.**



Shkrirja e ushqimit për foshnja

Me këtë cilësim, sensori i integruar e rregullon modelin e ngrohjes për mbajtje ngrohtë ose shkrirje. Nëse futni ushqim të ngrirë për foshnja, ngrohësja e shishes e shkrim ushqimin. Pas kësaj, fikeni ngrohësen e shishes dhe kalojeni te cilësimi i ushqimit të foshnjës për ta ngrohur në temperaturën e duhur.

1 **Vendosni enën e ushqimit të foshnjës në ngrohësen e shishes. Mbusheni me ujë të pijshëm deri në nivelin e ushqimit të foshnjës. Nëse keni sasi të madhe ushqimi për foshnja, mbusheni me ujë afro 1 cm poshtë majës së ngrohëses së shishes.**





2 **Zgjidhni cilësimin e mbajtjes ngrohtë/shkrirjes dhe shtypni butonin e ndezje/fikjes për ta ndezur.**

3 **Treguesi i ecurisë pulson për të treguar se ushqimi i foshnjës po shkrihet.**

4 **Për shkak të ndryshimeve në njëtrajtësinë e ushqimit të ngrirë të foshnjës, pajisja nuk ka mundësi ta kuptojë saktë se për sa kohë duhet shkrirë. Trazojeni ushqimin e foshnjës kur të ketë filluar të shkrijë.**

Bëni kujdes të mos digjni gishtat kur e mbani enën apo kavanozin gjatë trazimit.

Shënim

- P.sh. për të shkrirë një shishe 180 ml/6 oz ushqimi të ngrirë foshnjash, do të duhen 60 minuta. Koha e shkrirjes mund të jetë më e gjatë ose më e shkurtër në varësi të vëllimeve të ushqimit të foshnjës dhe materialit të enës.



5 **Ngrohësja e shishes fiket vetë pas rreth 60 minutash. Fiket treguesi i ecurisë.**



6 **Pas kësaj, zgjidhni cilësimin e ushqimit të foshnjës dhe shtypni butonin e ndezjes/fikjes për të kaluar te ngrohja e ushqimit të foshnjës.**



Shënim

- Sigurohuni që ngrohësja e shishes të fiket përpara se të rrotulloni graduesin te cilësimi i ushqimit të foshnjës. Përndryshe cilësimi i ushqimit të foshnjës nuk mund të aktivizohet.

7 **Treguesi i ecurisë pulson për të treguar se ushqimi i foshnjës po ngrohet.**

8 **Për shkak të ndryshimeve në njëtrajtësinë e ushqimit të foshnjës, pajisja nuk ka mundësi ta kuptojë saktë se për sa kohë duhet ngrohur. Trazojeni ushqimin e foshnjës gjatë ngrohjes. Për rezultate optimale, kontrollojini temperaturën gjatë ngrohjes.**

<u>Bëni kujdes të mos digjni gishtat kur e mbani enën apo kavanozin gjatë trazimit.</u>



9 Ngrohësja e shishes fiket vetë pas rreth 60 minutash, duke përfshirë kohën e ngrohjes. Fiket treguesi i ecurisë.

Pastrimi dhe deskorjezimi

Pastrimi

1 Hiqeni nga priza dhe lëreni të ftohet.

2 Hidheni ujin anash dhe jo përpara apo mbrapa, për t'u ruajtur të mos derdhet në dorezë ose në spinën kryesore.



3 Fshijeni me një leckë të lagur.

↳ Mos përdorni abrazivë, solucione antibakteriale pastrimi, solucione kimike apo mjete të mprehta për pastrimin e ngrohëses së shishes.



Shënim

- Nëse e keni përdorur ngrohësen e shishes për ngrohjen e ushqimit për foshnja, sigurohuni që të mos mbetet ushqim i derdhur në fund të ngrohëses.

Deskorjezimi

Rekomandohet ta deskorjezoni ngrohësen **çdo katër javë** për t'u siguruar që punon me efikasitet.
Për heqjen e çmërsit, përzieni 60 ml / 2 oz uthull të bardhë me 120 ml / 4 oz ujë të ftohtë. Ndizeni dhe lëreni në cilësimin e ngrohjes së qumështit për përmbajtje nën 180 ml/6 oz dhe lëreni pajisjen të punojë për 10 minuta. Lëreni solucionin në ngrohësen e shishes derisa të shpërbëhet e gjithë skoria.



Shënim

- Mund dhe të përdorni deskorjezues me bazë acidi citrik.
- Mos përdorni lloje të tjera deskorjezuesish.

Zbrazeni ngrohësen e shishes dhe shpëlajeni mirë nga brenda. Nëse shihni ende gjurmë skorjesh, përsëriteni procedurën e deskorjezimit.

Riciklimi

Ky simbol do të thotë që produktet elektrike nuk duhet të hidhen me mbeturinat e zakonshme të shtëpisë.
Zbatoni rregulloret e shtetit tuaj për grumbullimin e veçuar të produkteve elektrike.

Mbështetja

Për mbështetje për të gjitha produktet, si pyetjet më të shpeshta, vizitoni **www.philips.com/support**.

Shënim

- Konsumi i energjisë (modaliteti i pritjes): <0,3 W (kohë deri në modalitetin automatik të pritjes: <1 min)

Zgjidhja e problemeve

Ky kapitull përmbledh problemet më të shpeshta që mund të hasni me pajisjen. Nëse nuk keni mundësi ta zgjidhni problemin me informacionin e mëposhtëm, kontaktoni me qendrën e shërbimit të klientit për shtetin tuaj.

Problemi	Pas ndezjes së ngrohëses së shishes, treguesi i gjithë ecurisë pulson shpejt dhe fiket.
Shkaku	• Temperatura e ujit në shishe është shumë e lartë ose e ulët. • Aktivizohet mbrojtja ndaj tharjes nga avullimi.
Zgjidhja	• Fikeni dhe hiqeni nga priza. Lëreni të ftohet për pak minuta. Sigurohuni ta mbushni me ujë të freskët në temperaturë ambienti. • Ngrohësja e shishes fiket automatikisht dhe nëse është e ndezur dhe nuk ka fare apo nuk ka mjaftueshëm ujë në të. Fikeni dhe hiqeni nga priza. Lëreni të ftohet përpara. Sigurohuni ta mbushni mjaftueshëm me ujë të freskët në temperaturë ambienti. • Mbushni ngrohësen e shishes me ujë deri në nivelin e qumështit. Nëse keni sasi të madhe qumështi për të ngrohur, mbusheni me ujë deri afro 1 cm poshtë majës së ngrohëses së shishes. Ngrohësja e shishes është sërish gati për përdorim.
Problemi	Qumështi është shumë i nxehtë.
Shkaku	• Mund të keni zgjedhur një cilësim të gabuar ose po përdorni paketim qumështi. • Mund ta keni mbushur ngrohësen e shishes me shumë ujë.
Zgjidhja	• Zgjidhni cilësimin e vëllimit të qumështit sipas vëllimit të qumështit dhe jo përmasave të shishes. • Nëse përdorni paketim qumështi, zgjidhni cilësimin e mbajtjes ngrohtë/shkrirjes. • Mbushni ngrohësen e shishes me ujë deri në nivelin e qumështit. Nëse keni sasi të madhe qumështi për të ngrohur, mbusheni me ujë deri afro 1 cm poshtë majës së ngrohëses së shishes. Ngrohësja e shishes është sërish gati për përdorim.
Problemi	Qumështi është ende i ftohtë.
Shkaku	• Mund të keni zgjedhur një cilësim të gabuar, po përdorni shishe silikoni ose e keni mbushur ngrohësen e shishes me ujë të ngrohtë. • Mund të mos e keni mbushur ngrohësen e shishes mjaftueshëm me ujë. • Mund ta keni vendosur shishen në ngrohëse pas ndezjes së ngrohëses.
Zgjidhja	• Vendosni shishen në ngrohësen e shishes. Mbusheni ngrohësen e shishes me ujë të freskët në temperaturë ambienti. Mbushni ngrohësen e shishes me ujë deri në nivelin e qumështit. Nëse keni sasi të madhe qumështi për të ngrohur, mbusheni deri afro 1 cm poshtë majës së ngrohëses së shishes. Zgjidhni cilësimin e vëllimit të qumështit sipas vëllimit të qumështit dhe jo përmasave të shishes. Shtypni butonin për të nisur ngrohjen. • Nëse përdorni shishe silikoni, zgjidheni cilësimin e vëllimit të qumështit sipas vëllimit të qumështit. Kur treguesi i të gjithë ecurisë është i ndezur, pritni për 3-4 minuta që qumështi të ngrohet. • Mos përdorni ujë të ngrohtë.

Problemi	Pas ndezjes së ngrohëses së shishes, treguesi i gjithë ecurisë është i ndezur por nuk pulson.
Shkaku	• Ngrohësja është ende shumë e nxehtë për të ngrohur shishe tjetër. Mund të jetë që sapo keni përfunduar ngrohjen e një shisheje. Fikeni dhe lëreni atë të ftohet.
Zgjidhja	• Për ta përshpejtuar, rimbusheni ngrohësen me ujë të ri të ftohtë. Kur ta ndizni ngrohësen, treguesi i ecurisë mbushet gradualisht për të treguar se pajisja po ringrohet.
Problemi	Treguesi i gjithë ecurisë pulson gjatë ngrohjes së ushqimit për foshnja.
Shkaku	• Për shkak të ndryshimeve në njëtrajtësinë e ushqimit, pajisja nuk ka mundësi ta kuptojë saktë se për sa kohë duhet ftohur ushqimi për foshnja.
Zgjidhja	• Trazojeni ushqimin për foshnja ndërsa kavanozi apo ena është në ngrohëse. Për rezultate optimale, kontrollojini temperaturën gjatë ngrohjes.
Problemi	Unë ngroh të njëjtën sasi qumështi çdo herë, por koha e ngrohjes së qumështit është e ndryshme.
Shkaku	• Koha për ngrohjen e qumështit varet nga vëllimi ose temperatura fillestare e qumështit dhe e ujit. • Nëse qumështi është ftohur në frigorifer dhe fillimisht është i ftohtë, do të duhet më shumë kohë për ta ngrohur. • Nëse uji në ngrohësen e shishes është i ngrohtë ose i nxehtët, duhet më shumë kohë për ta ngrohur qumështit. Sensori rregullon modelin e ngrohjes për të shmangur mbinxehjen e qumështit.
Zgjidhja	• Për të siguruar të njëjtën kohë ngrohjeje, sigurohuni që ngrohësja e shishes të mbushet me ujë të mjaftueshëm të pijshëm në temperaturë ambienti.

© 2026 Koninklijke Philips N.V.
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.
2026-07-20